



Republika e Kosovës
Republika Kosovon - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 84

Prishtinë, më 21.11.2016, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S/N-204

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Armend Zemaj, Selvije Halimi, Agim Aliu, Nezir Çoçaj, Agim Ademaj, Danush Ademi, Valdete Bajrami, dhe Pal Lekaj.

Munguan: Doruntinë Maloku dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Arbenita Marmullaku-Bota Press; Ridvan Slivova-Telgrafi; Leonora Bërbatovci-RTK; Valdete Berisha-Arbresh.info; Dibran Istrefi-Klan Kosova; Alban Bujari-Koha Ditore; Pajazit Krasniqi-Radio Kosova; Gresa Ramadani-Vizitor; Ardian Nikolla-Zëri; Argjend Zejnaj-GR/AAK; Elsa Zyberaj-praktikante; Sanije Berisha-OSCE dhe Blerta Bejtullahu-EUSR-Office;

Nga Stafi Mbështetës i Komisionit: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Mbledhjen e kryesoi: Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim në lidhje me ftesën e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prizrenit, Sylë Hoxha dhe për ministren e Drejtësisë Dhurata Hoxha për raportim në Komision;
3. Shqyrtimi i shkresës së Këshillit Prokurorial të Kosovës që ka të bëjë me nenin 25 paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;
4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;
5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij;

6. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma;
7. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja propozoi që pika 2 e rendit të ditës të zhvendoset si pikë e fundit për arsye të debatit që mund të ketë në këtë pikë.

Kryetarja konstatoi se rendi i ditës miratohet me ndryshimin e propozuar.

2. Shqyrtimi i shkresës së Këshillit Prokurorial të Kosovës që ka të bëjë me nenin 25 paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-034 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit;

Komisioni, diskutoi lidhur me shkresën e Këshillit Prokurorial të datës 4 nëntor 2016, ku është kërkuar sqarim lidhur me nenin 25, paragrafi 4, të Ligjit nr. 05/L-034 për ndryshimin edhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit.

Lidhur me këtë, Komisioni sqaroi, se thirrja në referencën e Ligjit është gabim, sepse Ligji nr. 05/L-034, shqetësimin e ngritur e definon në nenin 11, i cili ndryshon nenin 25 të Ligjit nr. 03/L-225.

Neni 11 i Ligjit nr. 05/L-034, i cili riformulon nenin 25 të Ligjit nr. 03/L-225, e ka qartësinë e duhur normative, kur flet për veprimtaritë profesionale të prokurorëve. Paragrafi 4 i këtij neni nuk mund të interpretohet i ndarë nga paragrafët 1, 2 dhe 3, i këtij neni. Ky nen përcakton obligimet e Këshillit për aktivitetet e prokurorëve jashtë orarit të punës, dhe njëherësh cakton lartësinë e shpërblimit që nuk e tejkalon vlerën prej 25% të pagës bazë për veprimtaritë e parapara me këtë nen.

Kufizimi tillë është paraparë edhe në Ligjin nr. 05/L-032 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-199 për Gjykatat.

Andaj, është vlerësim i Komisionit se dispozita e ka qartësinë e duhur dhe ka përcjellë standard të njëjtë, si për prokurorët ashtu edhe për gjyqtarët.

3. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit FunkSIONAL në Projektligjin nr. 05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit;

Kryetarja e Komisionit paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit FunkSIONAL për Projektligjin nr. 05/L-090 për sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit. Lidhur me këtë kërkoj nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr.05/L-090 për Sponsorizime dhe donacione në fushën e kulturës, rinisë dhe sportit dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

4. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij;

Kryetarja e Komisionit paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 05/L-044 për zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij. Lidhur me këtë kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje.

Meqë nuk pati vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë.

R e k o m a n d i m

5. Projektligji nr.05/L-044 për Zonën e rrezikuar mjedisore të Obiliqit dhe rreth tij dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
 6. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
- 5. Shqyrtimi i Raportit me amendamente i Komisionit Funkcional në Projektligjin nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma;**

Kryetarja e Komisionit paraqiti për shqyrtim Raportin me amendamente të Komisionit Funkcional për Projektligjin nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma. Lidhur me këtë kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje

Meqë nuk pati diskutime, kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë.

R e k o m a n d i m

1. Projektligji nr. 05/L-091 për mbrojtjen nga zhurma dhe amendamentet e propozuara janë në pajtim me Kushtetutën dhe Ligjin e zbatueshëm.
2. Projektligji dhe amendamentet e propozuara mund t'i procedohen Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.
6. **Diskutim në lidhje me ftesën e kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore të Prizrenit Sylë Hoxha dhe për ministren e Drejtësisë Dhurata Hoxha për raportim në Komision;**

Kryetarja sqaroi arsyen se pse duhet ftuar në raportim kryeprokurori i Prokurorisë Themelore të Prizrenit Sylë Hoxha dhe ministrja e Drejtësisë, Dhurata Hoxha, ku tha se kjo ftesë ka të bëjë me faktin që me datën 5 nëntor 2016, në rrethana ende të dyshimta në Qendrën e Paraburgimit në Prizren, ka ndërruar jetë aktivisti i Lëvizjes Vetëvendosje Astrit Dehari. Me pas, znj. Haxhiu shprehu keqardhje se lidhur me këtë rast nuk ka pasur suspendime dhe asnjë përgjegjësi nga askush, pra, tha ajo, është dashur të japin dorëheqje ministrja e Drejtësisë dhe ministri Punëve të Brendshme, ku shtoi se ka pasur deklarata kundërthënëse lidhur me kohën dhe rrethanat e vdekjes, prandaj tha ajo, konsideroj se është shumë e rëndësishme që për të gjitha këto kundërthënie të ftohen në raportim kryeprokurori dhe ministrja e Drejtësisë, kur dihet se kjo e fundit është përgjegjëse për menaxhimin e burgjeve .

Pal Lekaj, tha se ky rast nuk është menaxhuar në mënyrë profesionale. Ka pasur mendime kundërthënëse si nga policia ashtu edhe nga prokuroria. Lidhur me këtë rast, sipas z. Lekaj është dashur që të japin dorëheqje përgjegjësit nga këto institucione. Me pas deputeti Lekaj tha se pajtohet që kryeprokurori Sylë Hoxha dhe znj. Dhurata Hoxha të ftohen para komisionit të japin sqarime lidhur me këtë rast.

Selvije Halimi, shprehu keqardhje për rastin duke thënë se ky rast ka prekur të gjithëve dhe se humbja e jetës në një institucion është e pajustificueshme, por konsideroj se çdo diskutim i personave politikë mund të jetë ndërhyrje indirekte apo direkte në institucionet të cilat janë duke u marrë me zbardhjen e rastit. Atë çka duhet të bëhet është të kërkohet që të bëhen ndjekje penale për secilin person i cili është i përfshirë në këtë rast, theksoi znj. Halimi.

Halimi në diskutimin e saj përmendi edhe rastin e vetëvrasjes së djalit tjetër të familjes Dehari para tri vitesh, ku tha se nuk kishte presion nga politika për zgjidhje të rastit dhe se ai ende mbetet i pazgjidhur. Ajo bëri thirrje që këto dy raste të zbardhen sa me shpejt.

Ndërsa, sa i përket ftesës për kryeprokurorin Hoxha, ajo tha se Komisioni nuk ka kompetencë ta ftojë në raportim kryeprokurorin, por vetëm ministren e Drejtësisë, megjithatë duhet pritur që rasti të zbardhet dhe më pas të ftohet Këshilli Prokurorial dhe ministrja e Drejtësisë, tha deputetja Halimi.

Albulena Haxhiu, shprehu habinë e saj në lidhje me qëndrimin e znj. Halimi, duke thënë se në kohën kur grupi parlamentar bënte përpjekje të mblidhte nënshkrime për seancë të jashtëzakonshme është kontaktuar edhe deputetja Halimi, e cila ka konfirmuar që do ta mbështesë një debat parlamentar për rastin Dehari. Por tani po shihet një ndryshim radikal ndaj qëndrimit që kishte më parë znj. Halimi e ky ndryshim mund të ketë ardhur nga presioni që mund ta kenë pasur deputetët që kjo seancë të mos mbahet.

Haxhiu theksoi se nëse në këtë vend nuk respektohen ligjet që i nxjerr vet Kuvendi, në qoftë se ka shkelje të vazhdueshme të ligjeve nga institucionet e sigurisë apo të drejtësisë, kush duhet të ndërhyjë për këto shkelje flagrante që po i bëhen legjislacionit, kur dihet se Kuvendi është institucioni më i lartë dhe duhet të ndërhyjë kur sheh shkelje të tilla, ndërsa sa i përket ministres së Drejtësisë, paraprakisht është dashur që kjo e fundit të konsultohet me familjarë për një hetim të pavarur të rastit e jo të marre vendime pa asnjë konsultim paraprak, kur dihet se nga subjekti i Vetëvendosjes dhe familjaret është kërkuar vazhdimisht që të bëhet hetim i pavarur.

Selvije Halimi, replikoi duke thënë se duhet pritur që rasti të zbardhet deri në fund, ndërsa tha se Komisioni nuk ka kompetencë sepse ftesa për kryeprokurorin Sylë Hoxha cilësohet konflikt interesi.

Armend Zemaj, tha është e ditur që Ministria e Drejtësisë është përgjegjëse për menaxhimin e burgjeve në Republikën e Kosovës, andaj Komisioni ka kompetencë të bëjë ftesë që e njëjta ministri të raportojë para Komisionit për Legjislacion.

Zemaj tha se vetëm një javë para se të ndodhte rasti Dehari, Komisioni kishte në raportim ministren e Drejtësisë, që për temë kishte trajtimin e raportit të Ministrisë së Drejtësisë për zbatueshmërinë e ligjeve në menaxhimin e burgjeve, dhe për çudi asnjë pyetje nuk është bërë nga ana e kryetares së komisionit për menaxhimin e burgjeve, do të thotë pyetjet e parashtruara ishin politike dhe jashtë interesit të kësaj teme.

Zemaj shtoi kërkesa për t'i bërë ftesë kryeprokurorit Sylë Hoxha, që të raportojë para komisionit është politike dhe interferimi në raste të veçanta sipas Kushtetutës cilësohet ndërhyrje në drejtësi.

Meqë debati kaloi në replika individuale mbledhja u ndërpre pa ndonjë konkluzion të veçantë.

Mbledhja përfundoi në orën 10:41.

E përgatiti;

Njësia për mbështetjen e komisionit

Kryetarja e Komisionit,

Albulena Haxhiu
